

Politika

e

Bashkëpunimit Institucional

e

Akademisë “Evolucion”

Prishtinë

2018

Në bazë të Statutit të Akademisë "Evolucion" (në tekstin e mëtejshëm: "AE"), Bordi i Drejtorëve (në tekstin e mëtejshëm "BD") i Akademisë "Evolucion" në seancën e mbajtur në Prishtinë më 20.12.2018 miraton këtë:

POLITIKË TË BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL TË AKADEMISË "EVOLUCION"

Neni 1

(Qëllimi dhe konteksti)

Qëllimi i këtij dokumenti është të sigurojë një kornizë që udhëzon dhe rregullon zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e partneriteteve institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me objektivat e bashkëpunimit të Akademisë "Evolucion" dhe orientimet e saj strategjike.

Neni 2

(Definicionet)

Për qëllimin e kësaj politike:

- a. Partneritetet Institucionale - i referohen partneriteteve në mes të Akademisë dhe universiteteve vendore dhe të huaja, kolegjeve dhe institucioneve të tjera arsimore dhe agjencive qeveritare si ministritë e arsimit dhe organet e financimit të bursave. Në veçanti, kjo politikë është e kufizuar në Memorandume formale të bashkëpunimit akademik, dhe Letra Shtesë të Marrëveshjes, siç janë marrëveshjet për shkëmbimin e studentëve. Nuk përfshin kontratat komerciale dhe programet komerciale. Megjithatë, kjo nuk përjashton që kontratat komerciale të zhvillohen më vonë me institucione që përkufizohen si Partnerë Institucionalë brenda kësaj politike.
- b. Memorandumi i Bashkëpunimit Akademik - i referohet një dokumenti me shkrim që formalizon qëllimin e Akademisë për t'u ndërlidhur me një institucion të arsimit të lartë për qëllimin e përgjithshëm të bashkëpunimit akademik në fusha të tilla si bashkëpunimi hulumtues, veprimtaria e përbashkët akademike dhe shkencore, stafi dhe

shkëmbimin e studentëve dhe shkëmbimin e botimeve dhe materialeve me interes të përbashkët.

- c. Marrëveshja Shtesë - i referohet një marrëveshjeje me shkrim e cila është shtesë e Memorandumit të Bashkëpunimit Akademik me një institucion partner të arsimit të lartë dhe e cili detajon aspektet e ndryshme të një forme të veçantë të bashkëpunimit akademik.

Neni 3 (Deklarata e politikës)

- 1) Partneritetet Institucionale duhet të zhvillohen në përputhje me Misionin objektivat strategjike të Akademisë dhe.
- 2) Numri i Partneriteteve Institucionale do të ndërlidhet me objektivat strategjikë dhe prioritet do t'u jepen partneriteteve që promovojnë dhe rrisin praninë e Akademisë në vende të përzgjedhura, rritin reputacionin e Akademisë në mbarë botën dhe nxisin marrëdhënie afatgjata dhe të thella.
- 3) Natyra e Partneriteteve Institucionale do të ndryshojë në pajtim me objektivat e Akademisë dhe të atyre të institucioneve të veçanta partnere.
- 4) Inkurajohet një shumëllojshmëri e Partneriteteve Institucionale me përcaktimin e synimeve të matshme.
- 5) Partneritetet Institucionale do të realizohen për qëllimet në vijim:
 - a. zhvillimin e projekteve të bashkëpunimit hulumtues;
 - b. organizimin e aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore, të tilla si kurse, konferenca, seminare, simpoziume apo ligjërata;
 - c. shkëmbimin e hulumtimit, mësimdhënies dhe personelit tjetër;
 - d. mobilitetin e studentëve, duke përfshirë shkëmbimin e studentëve dhe ose studimin jashtë vendit;
 - e. shkëmbimin e botimeve dhe materialeve të tjera me interes të përbashkët;
 - f. zhvillimin e projekteve të tjera të përbashkëta të bashkëpunimit për përfitim reciprok, që do të përcaktohen në ndërkohë;
 - g. zhvillimin e programeve të binjakëzimit, aranzhimet e artikullimit dhe programet e shkurtëra studimore të studimit.

Neni 4

(Llojet e marrëveshjeve)

- 1) Çdo Partneritet Institucional i përcaktuar nga kjo politikë do të formalizohet fillimisht nga një Memorandum i Bashkëpunimit Akademik.
- 2) Një marrëveshje e ndarë për shkëmbim të studentëve (Letër Shtesë e Marrëveshjes, Shkëmbim) do të jetë shtesë e Memorandumit të Bashkëpunimit Akademik, ku shfaqet aktiviteti i shkëmbimit të studentëve si pasojë e kësaj Marrëveshjeje.
- 3) Projektet e tjera të veçanta bashkëpunuese, gjithashtu do të detajohen në Letrën Shtesë të Marrëveshjes të Marrëveshjeve të Memorandumit të Bashkëpunimit Akademik, pas paraqitjes së atyre projekteve.

Neni 5

(Kushtet formale)

- 1) Të gjitha marrëveshjet janë objekt i një vlerësimi strategjik për të përcaktuar përshtatshmërinë e partnerit dhe përshtatshmërinë strategjike dhe nuk do të nënshkruhen nga Akademia derisa të gjitha implikimet e burimeve të identifikohen dhe të dakordohet alokimi i burimeve të nevojshme.
- 2) Memorandumi i Bashkëpunimit Akademik dhe / ose Letra Shtesë të Marrëveshjes, të miratuara me qëllim të formalizimit të partneritetit, mund të ofrohen nga secili partner, por duhet të jenë të pranueshme për të dy partnerët.
- 3) Preferohet që të gjitha marrëveshjet të jenë ndër-institucionale dhe se çdo marrëveshje bashkëpunuese midis njësisive akademike brenda ose në të dy institucionet të jetë shtesë e Memorandumit të përgjithshëm të Bashkëpunimit Akademik.
- 4) Drejtori Ekzekutiv (ose i emëruari) i Akademisë do të jetë nënshkruesi zyrtar i të gjitha Memorandumeve të Bashkëpunimit Akademik dhe Marrëveshjeve Shtesë.

Neni 6
(Përmbajtja e marrëveshjes)

- 1) Të gjitha memorandumet dhe marrëveshjet duhet të kenë një klauzolë rishikimi si dhe procedurat për përfundimin e tyre.
- 2) Të gjitha memorandumet dhe marrëveshjet duhet të nënshkruhen në kopje të shtypur. Originali do të depozitohet në Njësinë e dokumenteve zyrtare dhe Arkivit dhe një kopje elektronike do të ruhet në Arkivin elektronik të Akademisë.

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20.12.2018.

Kryesuesia BD



Besnik Shatri

